



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 126/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Cemil Luma nga radhët e subjektit politik KDTP, të paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit në QNR, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Cemil Luma nga radhët e subjektit politik KDTP

Arsyetim

Me datën 31.01.2011 PZAP ka pranuar një ankesë nga Cemil Luma, në të cilën pretendohet se në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë është njoftuar se ka fituar 32 vota, këtë e kanë deklaruar dy vëzhgues të SDA-së Muge Urcan dhe Salko Bulcan dhe se gjatë rivotimit me datë 09.01.2011 në Komunën e Skenderajt njëri nga komisionarët e QV në fshatin Polac Shaban Veliu deklaroi me përgjegjësi të plotë se 163 fletëvotime të subjektit politik KDTP kanë qenë të rregullta dhe janë pranuar nga zyrtarët përgjegjës.

Parashtruesi i ankesës ia ka bashkangjitur një kopje të listës me nënshkrime që sipas tij janë të votuesve të tij dhe dy deklarata si dëshmi njëra e Shaban Veliut dhe tjetra e vëzhguesve Muge Urcan dhe Salko Bulcan si dëshmi.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (b) dhe (c) parashohin si vijon:

b)një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar.

(c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

PZAP vlerëson se pretendimet e subjektit politik KDTP në ankesë, janë të pabazuara për shkak se nuk është ofruar asnjë dëshmi për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. Për më tepër, procesin votimit dhe përpilimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010/2011 e ka përshkruar një proces i gjatë dhe gjithëpërfshirës i kontrollimit, auditivit dhe verifikimit të saktësisë së të dhënave dhe rezultateve. Në rezultatet përfundimtare të QNR-së të shpallura nga KQZ-ja me 30 janar 2011 është përfshirë edhe numri i votave me kusht, votave të votimit përmes postës dhe atyre me nevoja te veçante. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 126/2011 më datën 02.02.2011.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

